




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, info.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Duke u bazuar në nenin 11 dhe 12 të LVL, nenin 38, paragrafi 1.2 dhe 1.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit, në harmoni me Planin e Plotësuar Rregullues Urban "Fidanishte", me Rekomandimin e Komitetit për Pronë, Kadastër dhe Banim të dt. 18.06.2012, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me datë 29.06.2012, miraton këtë :

V E N D I M

Për shpalljen Zonë me interes të veçantë publik .

I.

Me këtë Vendim, Komuna e Gjilanit Shpallë Zonë me interes të veçantë publik ngastrat kadastrale: **P-70403013-01963-2**, me sipërfaqe prej **3581 m²**; **P-70403013-01962-1** me sipërfaqe prej **630 m²**, të cilat gjinden te vendi i quajtur "Fidanishte" dhe evidentohen në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme L.Nj. 1730, Zona Kadastrale Gjilan, në emër të P.Sh. Kombinati Bujqësor Industrial Gjilan, si dhe ngastra kadastrale **P-70403013-1961-9** me sipërfaqe prej **367 m²**, te vendi i quajtur "Fidanishte" e cila evidentohet në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme L.Nj. 9275, Zona Kadastrale Gjilan, në emër të Kombinatit Bujqësor Industrial nga Gjilani si bashkëpronarë i $\frac{1}{2}$ të pjesës ideale si dhe në emër të N.Sh. "Mekanizmi" Prishtinë si bashkëpronarë i $\frac{1}{2}$ i pjesës ideale të kësaj parcele. Sipërfaqja e tërësishme e këtyre tri ngastrave është **4578 m²**.

II.

Parcelat e cekura në pikën I të këtij Vendimi do të përdoren për implementimin e Planit të Plotësuar Rregullues Urban "Fidanishte", të miratuar nga ana e Kuvendit Komunal, me Vendimin 01.Nr.16/7083 në seancën e mbajtur me dt. 30.05.2011, sipas destinimit për rrugë publike dhe shteg të këmbësorëve të cilat janë si pjesë përbërëse e kësaj zone të ndërtimit.

III.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.

IV.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

01.Nr.16-69765
Gjilan, më 29.06.2012

Kuvendi i Komunës

Izmi ZEKA, Kryesues